


Dritëro  
Agolli

**DHJETE  
SY**

**VJERSHA  
DHE POEMA**



891.1.22-1

JH-1  
A37

Biblioteka e Pionierit

DR. TERO  
AGOLLI



**Dhjetë  
sy**

Vjersha dhe poema



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

33/37

Faint, illegible text or markings at the top of the page.

1.

Viersha

## SA I ÇUDITSHËM

Ju, vajza të vogla e djem të vegjël të mbarë,  
Me sy ndonjë poet a keni parë?

Me ju poeti shëmbëllen, fëmijë,  
Po mund t'i ketë flokët dhe me thinjë

Dhe qejf i ka dhe përrallat dhe rrëfimet,  
Çuditet me dëborën dhe blerimet.

Qëndron përpara fletëve të pemës,  
I krahason me vargjet e poemës.

Vrapon në breg, ku valë e detit ndal,  
Dhe valës, për habi, i thotë mal.

E ndjek me sy kur fluturon një flutur,  
Përpjek shuplakat: «Qenka shumë e bukur!»

Dhe niset vrap, si Tani, shpejt ta kapë,  
Që mes pëllëmbës krahët pak t'ia hapë.

Ai si ju kudo ka qejf të futet,  
Në arat e fabrikat e në butet.

Bile harbon edhe në shesh të lodrave  
Dhe hyn në lumë mes për mes kodrave.

Në breg të lumit luan dhe me gurë,  
Megjithëse thinja ka dhe është burrë!

Atij, po iu mbush mendja, ngjitet malit  
Në këmbë edhe në samar të kalit

Dhe zbret t'i shohë zogjtë në gëmushë  
Dhe bën si zogjtë ciu-ciu-ciu me buzë!

Pastaj dhe rrokulliset nëpër bar,  
Fap në kurriz, po fap edhe në bark...

Tamam si ju, o çuna, o fëmijë,  
Çdo gjë trazon, çdo gjë kërkon ta dijë!

Dhe po t'i thonë: «Mos, se s'është mirë!»  
Si ju var buzët dhe i vjen vështirë.

I di fabrikat edhe natën vonë  
Dhe vargje shkruan dhe lëviz në dhomë.

Vrapon pas fjalës shumë të vështirë,  
E kap si peshk dhe qesh, se i vjen mirë.

Dhe hidhet me një këmbë në parket,  
Tamam si ju, «e gjeta!» zë thërret.

I thotë mami: «Fli, po zbardh mëngjesi!»  
Ia kthen: «Akoma s'po këndon këndesi.»

Sa i çuditshëm qenka ky poeti,  
Tamam si Tani, Lona, Vjollca, Meti...

Tamam, tamam... po vetëm se di shumë  
Kur flini ju si zogjtë, nuk bën gjumë...



## PËRRALLA E KECËRVE

1.

Xhaxhi Driteroi di përralla të bukura  
Për dhelpra, dhi e kunadhe.  
Thuajini xhaxhit, moj flutura:  
Tregona një përrallë të madhe!  
Dhe xhaxhi atherë do lerë  
Librin e tij në tryezë,  
Përralla në mend do t'i bjerë,  
Përralla për kecërit e dhinë e zezë.

2.

Na ishte, ç'na ishte njëherë...  
Dëgjoni, që fjalët mos mbeten në erë!  
Dëgjoni që fjalët në kokë të hyjnë  
Dhe njëra-tjetrën në radhë mos shtyjnë,  
Mos shahen e kurrë mos bëjnë shamatë,  
Se mendja pastaj i nxjerr jashtë.

Dhe mendja prandaj është mendje,  
Se rregull kërkon nga mëngjesi në  
mbrëmje...

3.

Pazarit po shkonte ngadalë nëna dhi  
Me kecërit e saj lozonjarë.  
Po shkonte në librari  
T'u blinte dy abetare.  
— U rritët,

u bëtë si cjepër! —  
U thoshte nëna fëmijëve. —  
Dhe duhet ta dini patjetër  
Si shkruhet gjuha e dhive!  
Dhe gjuha s'mësohet fare  
Po s'blemë dy abetare.

4.

Dhe shkuan kecërit dhe dhia  
Në rrugën me dy librarira,  
Në njërën, që quhej «Shkëndija»,  
Radhiteshin libra të mira  
Dhe kecërit të dy u çuditën  
Dhe brenda u futën e s'pritën.